



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shtator 2024**

**Data 27.09.2024 ora 14:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Rendi i dites:**

1. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2024.
2. Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës të Vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas VKM nr.625 datë 26.06.2024 dhe VKM nr.419 datë 26.06.2024.
3. Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës të Vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të VKM nr.328 datë 31.05.2023”
4. Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.90 datë 21.12.2023 për “Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024.
5. Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha pjesë e pasurisë nr.546/4, Zk nr. 3506, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, Nj. Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës.
6. Projekt vendim për dhënie në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Vau Dejës “Për përdorim rruge, tubacion dhe linje të tensionit të lartë në funksion të HEC Gjader”
7. Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z. Ndoc Marku në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuarit “Besa” Barbullush.
8. Projekt vendim për pranimin e të moshuaraes Znj. Age Pjetri në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuarit “Besa” Barbullush.
9. Projekt vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit nr.10860/1 prot datë 13.09.2024, për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje.
10. Projekt vendim për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës Dom Angelo De Padova.
11. Të ndryshme



Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shtator 2024, u zhvillua me datë 27.09.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 18 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Gusht 2024, te perfitojne 134 familje, me 461.790 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Gusht 2024 janë shpallur fitues, 1.021 familje, me fond 7.696.961 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 461.817 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës të Vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas VKM nr.625 datë 26.06.2024 dhe VKM nr.419 datë 26.06.2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Renado Doda -përgjegjës i zyres financë buxhetit, i cili relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Z.Renado Doda spjegoi për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi VKM nr.425 datë 26.06.2024 për ndryshimin e nivelit të pagave për administratën e punonjësve të konviktit, QKF, edukatoreve si dhe shtesat për vjetërsi në punë, kjo e specifikuar sipas llogarive ekonomike. Gjithashtu u spjegua se ishte zbatuar me korrektesi VKM nr.419 datë 26.06.2024 për ndryshimin e nivelit të pagave për administratën e punonjësve të zjarrfikëseve si dhe shtesat për vjetërsi në punë, kjo e specifikuar sipas llogarive ekonomike. Nivelet e pagave që do ndryshohen janë të pasqyruara në projekt vendimin që kemi paraqitur për shqyrtim.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro**, Z.Gjon marku nuk mori pjesë në votim.

Në këtë moment bëhet pjesëmarrës në mbledhje edhe këshilltari Z.Ermir Tahiri (i cili kishte njoftuar paraprakisht se do jetë prezent me pak vonesë)dhe numri i këshilltarëve prezent bëhet 19 këshilltarë.

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës të Vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të VKM nr.328 datë 31.05.2023”

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Renado Doda -përgjegjës i zyrës financë buxhetit,i cili relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.Z.Renado Doda spjegoi për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi VKM VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të VKM nr.328 datë 31.05.2023”për ndryshimin e nivelit të pagave për punonjesit e administrates së Bashkisë Vau Dejës, si dhe shtesat për vjetersi në punë, shtesa është e specifikuar sipas llogarive ekonomike.Ndryshimi i nivelit te pagave për punonjësit e administrates së Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024, është e specifikuar duke filluar nga Kryetari i Bashkise, nën kryetarët,sekretari i këshillit bashkiak, këshilltarët e kabinetit të kryetarit, drejtorët e drejtorive, përgjegjësat e sektorëve, specialistat,administratoret sipas njësive administrative si dhe shtesa për vjetersi pune, të gjitha këto të pasqyruara në projekt vendim.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, 1 votë abstenim** (Z.Gjon Marku) .

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:**

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.90 datë 21.12.2023 për “Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar,nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Renado Doda -përgjegjës i zyrës financë buxhetit,i cili relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur.Z.Renado Doda spjegoi për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi VKM VKM nr.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të VKM nr.328 datë 31.05.2023”, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore.Z.Renado Doda



spjeron se janë paraqitur në projekt vendim ndryshimet e nivelit të pagave sipas pozicioneve të punës, kategorive dhe nivelit arsimorë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga pyet: A mund të rritet niveli i pagës së Kryetarit Bashkisë?

Z.Renado Doda përgjigjet se për të gjithë punonjësit e administratës është aplikuar niveli minimal i rritjes sipas VKM.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, 1 votë abstenim** (Z.Gjon Marku) .

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit , me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha pjesë e pasurisë nr.546/4, Zk nr. 3506, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, Nj.Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Ndoc Baqli-përgjegjës i zyres asetëve pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit.Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së konkurimit publik, sipas legjisllacionit në fuqi.Gjithashtu dhënia në përdorim e kesaj siperfaqe e llojit “Pa fryt”e cila është e çertifikuar në emër të Bashkisë Vau Dejës, do sjell të ardhura vjetore për bashkinë, vlerën minimale prej 27000 lek.

Z.Ervis Shimaj informon këshilltarët se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 19.09.2024 me banorët e fshatit Stajkë, dhe se të pranishmit ishin shprehur dakort me dhënien në përdorim të kesaj sipërfaqe prej 1 ha, e llojit “Pa fryt”, nuk kishin probleme me ish pronarët e vjeter.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Gjon Marku pyet: Për vendimet që kemi marrë deri tani,si janë zbatuar kontratat?

Z.Ndoc Baqli pergjigjet: Në mbledhjen e muajit të ardhshëm do sjellim një raport të detajuar.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.**

#### **Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:**



Projekt vendim për dhenie në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Vau Dejës "Për përdorim rruge, tubacion dhe linje të tensionit të lartë në funksion të HEC Gjader"

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Mark Suli-specialist inxhinjer i zyrës pyjeve pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili shpjegon për këshilltarët se është zbatuar me korrektesë baza ligjore për hartimin e projekt vendimit. Vlera e dhënies me qira vjetore do të jetë sipas VKM nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Gjithashtu dhënia në përdorim e kesaj sipërfaqe pyjore, do sjell të ardhura vjetore për bashkinë, vlerën prej 1.826.630 lek. Subjekti ka detyrime të prapambetura pa likuaduar kundrejt Bashkisë Vau Dejës sipas kontratave nr.6255 prot. datë 18.09.2018 dhe nr.6894 prot. datë 06.12.2021, vlera të cilat duhet ti likuadojë dhe pas likuidimit propozojmë lidhjen e kontratës së re.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Znj. Sanije Salja pyet: Ky subjekt është debitor nga viti 2019, pse ka qenë pa kontratë.

Z. Mark Suli përgjigjet: Ne si zyrë kemi tentuar disa herë që subjekti të paraqitet pranë Bashkisë për të bërë kërkesë për rinovim kontrate, por nuk është paraqitur dhe këtë rradhë është paraqitur dhe ne si Bashki, do të rinovijmë kontratën pasi të shlyej detyrimet e prapambetura.

Znj. Sanije Salja-Nuk duhet të miratojmë vendimin pa likuaduar detyrimet.

Z. Mark Suli përgjigjet: Rinovimi i kontratës do bëhet pasi të likuadojë detyrimet e prapambetura.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, 1 votë abstenim (Znj. Sanije Salja).**

**Z. Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z. Ndoc Marku në Qendrën e Përkujdesit rezidencial për të moshuarit "Besa" Barbullush.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Aurela Deda- specialiste e sektorit të shërbimit social pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila shpjegon përpara këshilltarëve se Z. Ndoc Marku ka paraqitur kërkesën pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 date 09.03.2023 "Për ngritjen e Komisionit Multidisiplinare për vlersimin e rasteve të personave që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit dhe ka rezultuar se i



moshuari Z.Ndoc Marku i plotëson kriteret për tu pranuar pranë Qendrës së Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Age Pjetri në Qendren e përkujdesit rezidenciale për të moshuarit "Besa" Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Aurela Deda- specialiste e sektorit të shërbimit social pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila spjeron përpara këshilltarëve se Znj.Age Pjetri ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 date 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinare per vlersimin e rasteve te personave qe kane nevojë per sherbime te kujdesit shoqerore komunitare dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit dhe ka rezultuar se e moshuara Znj.Age Pjetri i plotëson kriteret për tu pranuar pranë Qendrës së Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit nr.10860/1 prot datë 13.09.2024, për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

Z.Ervis Shimaj spjeron për këshilltarët se në zbatim të VKM nr.435 datë 26.06.2024, për një shtesë në VKM nr.867 datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore", këshilli Bashkiak Vau Dejës, në mbledhjen e radhës së muajit Shtator 2024, duhet të miratojë marrëveshjen e bashkëpunimit nr.10860/1 prot datë 13.09.2024, për caktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Vau Dejës në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje.



Gjithashtu kush ka pyetje apo paqartësi mund ti drejtohen Kryetarit të Bashkisë i cili është prezent.

Z.Gjon Marku- Unë e shikoj si bashkëpunim shumë i duhur dhe kërkoj nga Kryetari Bashkisë ta shikojë me vëmendje këtë problem që të mos mbesin në heshtje problemet e legalizimit.

Z.Kristian Shkreli-Kryetarë i Bashkisë përgjigjet: Pranë ASHK-së, do jenë 2 punonjës që do merren vetëm me çështjet e territorit të Bashkisë Vau Dejës dhe do paguhen me të ardhurat e Bashkisë, puna do vijojë sipas zonave.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.**

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës Dom Angelo De Padova.

Z.Ervis Shimaj spjegon për këshilltarët se projekt vendimi i hartuar nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit, sektori i asistencës ligjore, çështjeve gjyqesore dhe kontratave, për dhënien titulli “ Qytetar Nderi “ me propozim të Kryetarit të Bashkisë, figurës së Dom Angelo De Padova për vlerat e tij dhe për kontributin që ka dhënë për në familjet në nevojë dhe të pastreha në fshatrat Ashtë dhe Kosmaç të Bashkisë Vau Dejës i propozoj këshilltarëve miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro.**

**Pika njëmbëdhjetë: Të ndryshme.**

Z.Gjon Marku ngre shqetësimin se në disa rrugë të qytetit Laç, janë djegur disa llampa ndriçuese.

Z.Kristian Shkreli- Kryetarë i Bashkisë përgjigjet: Brenda një periudhe të shkurtër do konstatohet problemi dhe do riparohen.

Znj.Saniye Salja ngre problemin e doktorit në fshatin Bushat dhe kërkon që mjeku të jetë të pakten 2 herë në javë.

Z.Kristian Shkreli- Kryetarë i Bashkisë përgjigjet:E kemi ngritur si problem pranë DSHSHP dhe jemi në pritje të zgjidhjes së problemit, presim emërimin e një mjeku për fshatin Bushat.



Mbasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera, Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 27.09.2024.

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian ÇELEPIJA**



Këshilltarët:

- Ferris Sllaj*
- Melika Zekero*
- Neli Idrizaj*
- Ramu Kelgu*
- Marin Rostaj*
- Mojlinda Ndreja*
- Ornela Lleshi*
- Allina Livolli*
- Prita Bresi*